

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-195/14

Prishtinë, 3 janar 2016

Në çështjen juridike të:

Z. B.

Kolegji i Apelit i AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Gjyqtarët: Sylejman Nuredini, Kryetar Kolegjit, Rolandus Bruin dhe Beshir Islami, duke vendosur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KKPK) KPCC/D/A/220/2013, i datës 27 nëntor 2013, lënda e regjistruar në Agjencionin Kosovar të Pronës (në tekstin e mëtejme: AKP) nën numrin KPA17767, pas seancës gjyqësore, të mbajtur më 3 shkurt 2006, mori këtë:

AKTGJYKIM

Hedhet si e paafatshme ankesa e Z. B. e paraqitur kundër vendimit të KKPK-ës Nr. KPCC/D/A/220/2013, i datës 27 nëntor 2013, për sa i takon lëndës së regjistruar në AKP nën numrin KPA17767.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Me 5 janar 2007, Z. B. (në tekstin e mëtejshëm: Ankuesja) e paraqitur në AKP duke kërkuar vrvrtetimin e së drejtës së bashkëpronësisë dhe riposedimin – aq sa është e rëndësishme këtu – ngastrat kadastrale me numrat 272 dhe 273 në Banjicë në Komunën e Istogut.
2. Në vendimin e KKPK-së nr. KPCC D/A/220/213 i datës 27 nëntor 2013, është hedhur Ankueses me arsyetim se humbja e pronës nuk ishte si rezultat i konfliktit të armatosur në periudhën kohore 1998/99, por si rezultat i tjetersimit vullnetar të këtyre pronave. Sipas dokumenteve të gjetura nga AKP-ja aktgjykimi i plotfuqishëm C.nr.243/05 i datës 5 janar 2006, i nxjerrë nga Gjykata Komunale në Istog – S. dhe R. B., më herët bashkëpronar të këtyre ngastrave, i kishin shitur ato A.K. Ky aktgjykim është bazuar në kontratën juridikisht të vlefshme, w vërtetuar në Gjykatën Komunale në Istog nën numrin 167/06, i datës 17 shkurt 2006.
3. Ankuesja ka pranuar vendimin e KKPK-ës me 26 maj 2014.
4. Ajo ka ushtruar ankesën, e datuar me 27 maj 2014. KKPK-ja ka pranuar ankesën me 1 korrik 2014 e cila është konfirmuar në kontstatimin e AKP-ës me datë 1 tetor 2014 me numër Ref.Nr.KPA17767.
5. Ankuesja pretendon se KKPK-ja nuk përmban arsye bindëse, për shkak se ajo nuk kishte shitur pronar e kërkuara ashtu siq provohet nga Fleta Poseduese Nr. 99 e cila e ka dorëzuar në AKP.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesave:

6. Gjykata Supreme pas shqyrtimit të ankesës së ushtruar sipas nenit 194 të LPK-së gjeti se ankesa është e pasafatshme.
7. Gjykata Supreme e Kosovës i referohet nenit 186, paragrafi 1 lidhur me nenin 196 të LPK-së.
8. Ankuesja ka pranuar vendimin e KKKPK-së me 26 maj 2014, ndërkaq që ankesa që ankesa është pranuar nga AKP-ja me 01 korrik 2014. Nga kjo mund të konstatohet se Ankuesja ankesën e ka paraqitur pas afatit prej 30 ditësh të parashikuar me dispozitën e nenit 12 par. 1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, për shkak se afati kohor ka përfunduar të mërkurën me 25 qershor 2014. Me këtë dispozitë ligjore parashikohet se ankesa kundër vendimit të KPCC mund të ankimohet brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimit.
9. Ankesa mban datën 27 maj 2014, por nuk ka ndonjë indikacion se ajo e kishte ushtruar ankesën në këtë datë.
10. Për më tepër, ajo nuk ka prezentuar ndonjë arsye të bazuar për të arsyetuar ushtrimin e saj të ankesës pas afatit të paraparë ligjor prej 30 ditësh.
11. Rrjedhimisht mbi të mësipërmen e sipas dispozitës së nenit 13 par. 3 nënpar. b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, Gjykata Supreme ka vendosur si në dispozitivin të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore:

Sipas 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, E

Rolandus Bruin, Gjyqtari i EULEX-i

Beshir Islami, Gjyqtar

Sandra Gudaityte, Referente e EULEX-it